



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:914253

Datë: 01.02.2024

Numri i dokumentit: 05275317

C.nr.2880/2022

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, në përbërje me gjyqtarin Ibrahim Maloku si dhe me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Festim Zeqiri, duke vendosur në çështjen juridiko-civile të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli në Prishtinë rr. Lidhja e Pejës, Magj Prishtinë - Fushë Kosovë p.nr, kundër të paditurit N.P, nga fshati Pomezetin Komuna Fushë Kosovë, të cilin me autorizim e përfaqëson Xhevat Bici avokat nga Prishtina, me objekt të kërkesëpadisë rimbursim i dëmit, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës 30.01.2024, gjykata me datë 01.02.2024, nxori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërsi e bazuar kërkesëpadia e paditësit Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli në Prishtinë, ashtu që:
- II. DETYROHET i padituri N.P, nga fshati P. Komuna Fushë Kosovë, që paditëses, në emër të rimbursimit të dëmit material për aksidentin e shkaktuar me datë 11.12.2013 në Obiliq, t'ia paguaj shumën prej 528.00€, me kamatë ligjore prej 8% llogaritur nga data e parashtrimit të padisë 26.10.2017 e deri në pagesën definitive të detyrimit, si dhe shpenzimet procedurale në shumën prej 170.00 €, të gjitha në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja me datë 26.10.2017, në gjykatë ka paraqitur padi për rimbursim të dëmit material dhe jo material kundër të paditurit. Gjykata lidhur me këtë lëndë ka zhvilluar procedurën kontestimore në drejtim të vendosjes meritorie lidhur me të njëjtën dhe me datë 16.10.2018 ka nxjerrë Aktgjykimin C.nr.2865/17 duke vendosur si në të njëjtin. Në bazë të procedurës ankimore të zhvilluar sipas ankesës së paditëses, Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë, me Aktvendimin AC.nr.3634/19, të datës 26.04.2022, e ka aprovuar të themeltë ankesën dhe lëndën ia ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Pas pranimit të lëndës, analizimit të vërejtjeve të dhëna nga gjykata e shkallës së dytë dhe me qëllim të eliminimit të të njëjtave, gjykata ka mbajtur seancë përgatitore për datën 07.11.2023 në të cilën kan prezantuar të autorizuarit e palëve në procedurë.

E autorizuar e paditësit, në padi dhe gjatë seancave gjyqësore ka deklaruar se qëndron në tërsi pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke theksuar se i padituri me datë 11.12.2013 rreth orës 13:00 në Obiliq ka shkaktuar aksident trafikës me automjetin mjet pune - Lugë ngarkuese, ku deri tek ky aksident ka ardhur nga pakujdesia e të paditurit, i cili i ka shkaktuar dëme të dëmtuarit BG, automjeti me të cilin

është shkaktuar ky aksident ka qenë pa mbulesë siguruese respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit. Ka shtuar se lidhur me dëmet e pësuar i dëmtuari BG, paditësja në bazë të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia dhe në bazë të LMD-së i ka kompensuar dëmin material dhe jo material të pësuar nga ky aksident dhe përkundër tentimit në procedurë jashtëgjyqësor të realizoj rimbursimin nga i padituri i njëjti ka qenë i pamundur.

Gjatë rigjyqimit, paditësja i ka propozuar gjykatës që me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike i propozojmë gjykatës nxjerrjen e provës me ekspertizë të komunikacionit. Mbi bazën e të lartcekurave i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tersi kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet i padituri që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jo material të ia paguaj shumën prej 528.00 € me kamatë ligjore 8% nga dita e paraqitjes së padisë si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

I autorizuari i të paditurit, në përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalë përfundimtare e ka kontestuar në tersi kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se automjeti ngarkues të cilin e ka drejtuar i padituri nuk është pronë e tij, por është pronë e ndërmarrjes Thëngjilli sh.a në Obiliq dhe se ky ka qenë vetëm punëtor. Ky lloj automjeti nuk i nënshtrohet regjistrimit e as sigurimit të detyrueshëm kështu që paditësja për shkaqe që i din ajo ka bërë pagesën e dëmit pa pasur detyrim ligjor, sepse për automjete që nuk i nënshtrohen regjistrimit dhe nuk paguhet sigurimi i detyrueshëm, e njëjta nuk duhet të bëj pagesën e dëmit që ka përjetuar automjeti i siguruar. Kjo rrethanë është vërtetuar edhe nga deklarimi eksperti i cili ka deklaruar se automjeti në fjalë nuk është i detyrueshëm të sigurohet e as të regjistrohet, kështu që për dëmin eventual që ka pësuar i dëmtuari ka mundur të realizoj drejtpërsëdrejti prej pronarit të automjetit – ngarkuesit. Fakti se paditësja ka bërë pagesën e këtyre mjeteve dhe tani kërkojnë rimbursimin kjo bjen në barrë të paditëses, sepse e njëjta ka paguar dëmin për të cilin sipas dispozitave ligjore nuk ka qenë e detyruar të paguaj, prandaj për këtë arsyeje ka theksuar se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar dhe i ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tersi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka bërë administrimin e provave materiale në shkresat e lëndës dhe atë: urdhërtransferi i të paditurës i datë 06.01.2014, ujdia jashtëgjyqësore e të paditurës e datë 06.01.2014, vendimi i të paditurës nr FK-2318/2013 i datë 26.12.2013, vendimi i të paditurës- komisioni i shkallës së parë për trajtimin e dëmeve dosja nr. 2318/2013 dt 26.12.2013, raporti i policisë me nr. 2013-AJ-0620 i datë 11.12.2013, skica nga vendi i ngjarjes, akt vlerësimi i dëmit i lëshuar nga e paditura i datë 26.12.2013, procesverbali mbi dëmtimin e automjetit e përpiluar nga e paditura i datë 18.12.2013, si dhe ekspertiza e ekspertit Sejdi Berisha e datë 19.12.2023. Pasi që Gjykata ka bërë vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në nenin 8 të LPK-së arriti në përfundim se në këtë çështje juridike duhet të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga raporti i policisë me nr. 2013-AJ-0620 i datë 11.12.2013 dhe skica e vendit të ngjarjes, gjykata gjeti se pas aksidentit - shkaktimit të dëmit, rasti është paraqitur në polici ku në raport nga policia është konstatuar se me datë 11.12.2013 rreth orës 13:00 ka ndodhur aksident trafiku brenda rrethojës së Kosova "A" tek Kosova Thëngjilli dhe në këtë aksident ka qenë e përfshirë mjete i punës dhe kamioneta ku lëndime trupore ka pësuar personi BG i cili edhe ka pranuar ndihmë mjekësore në ambulanten e qytetit dhe deri tek ky aksident ka ardhur për shkak të lëvizjes mbrapa në mënyrë të pakujdesshme të mjetit duke e goditur automjetin në pjesën e parë ana e djathtë në derë.

Nga procesverbali mbi dëmtimin e automjetit e përpiluar nga e paditura dhe akt vlerësimi i dëmit i lëshuar nga e paditura i datë 26.12.2013, gjykata konstatoi se është bërë konstatimi i pjesëve të cilat i janë dëmtuar pronarit BG dhe shuma e përgjithshme e këtij dëmi të pësuar është vlerësuar në lartësi prej 528.00€, ndërsa nga vendimi i komisionit për të shkallës së parë për trajtim të dëmeve dosja nr.2318/13 e datës 26.12.2013 gjykata gjeti se e paditura ka vlerësuar se ka bazë juridike për

kompensim dhe rrjedhimisht me vendimin e të paditurës nr FK-2318/2013 i datë 26.12.2013 është miratuar ky kompensim.

Nga ujdia jashtëgjyqësore e datë 06.01.2014 e lidhur mes të paditurës dhe paditësit, gjykata gjeti se duke qenë i kënaqur me shumën e kompensimit të vlerësuar nga e paditura, i dëmtuari B G ka lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore ku në emër të zhdëmtimit është caktuar shuma prej 528.00 €, ndërsa nga urdhërtransferi i të paditurës i datë 06.01.2014, gjykata gjeti se kjo shumë edhe i është paguar palës së dëmtuar.

Nga ekspertiza e komunikacionit e përpiluar me datë 19.12.2023, gjykata gjeti se deri tek aksidenti ka ardhur deri sa i padituri ka filluar veprimin e lëvizjes mbrapa dhe nga pakujdesia me pjesën e pasme ballore e ka goditur automjetin B në anën e djathtë i cili ka qenë duke lëvizur dhe se deri tek ky aksident nuk do të kishte ardhur në qoftë se i padituri do ti kishte marr të gjitha masat e sigurisë dhe mos të kishte vepruar pa u bindur se nuk i rrezikon pjesëmarrësit tjerë pasi që nga pakujdesia kur e ka nisur mjetin për lëvizje mbrapa e ka shkaktuar aksidentin me lëndime trupore dhe materiale. Gjithashtu nga kjo ekspertizë gjykata konstaton se ngasësi ka pas mundësi të perceptoj edhe ardhjen e automjetit të cilit i ka shkaktuar dëm, mirëpo i padituri e ka neglizhuar rrezikun dhe në mënyrë të pakujdesshme ka filluar veprimin e tij duke lëvizur mbrapa.

Gjithashtu nga ekspertiza e komunikacionit gjykata konstatoi edhe rrethanën se ngasësi i automjetit B i cili ka pësuar dëmin nuk ka dhënë kontribut në shkaktimin e këtij aksidenti dhe se shkaktar i drejtpërdrejtë i aksidentit është i padituri.

Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit sa i përket rimbursimit të dëmit material është e bazuar dhe të njëjtën vendosi që ta aprovoj në tërsi si të bazuar.

Gjykata vlerëson se i pakontestueshëm është fakti se nga aksidenti i datës 11.12.2013 i padituri me veprimet e tij ka shkaktuar aksidentin, nga i cili personi B. Gka pësuar dëme. Kjo gjendje faktike përkatësisht fakti se i padituri ka qenë përgjegjës në shkaktimin e aksidentit, është vërtetuar në mënyrë bindëse nga ekspertiza e komunikacionit e punuar nga eksperti Sejdi Berisha me datën 19.12.2023, të cilës Gjykata ia fali besimin në tërësi, ngase e njëjta ka ofruar mjaftueshëm konstatimet mbi situatën se si ka ardhur deri tek aksidenti në fjalë, dhe mbi faktin se me lëshimet e cilës palë ka ardhur deri tek aksidenti në fjalë. Ekspertizës në fjalë Gjykata ia fali besimin edhe për faktin se e njëjta është dhënë mbi bazën e njohurive profesionale të ekspertit në lëmin e komunikacionit, të cilat për gjykatën konstatimet e tilla kanë qenë të pranueshme, e që e vërtetojnë edhe shkaktarin e aksidentit. Madje ekspertiza në fjalë nga i autorizuari i të paditurit nuk është kundërshtuar, madje nuk ka patur as propozime për nxjerrje të ekspertizës tjetër.

Duke qenë se automjeti me të cilin i padituri ka shkaktuar dëmin, ka qenë pa mbulesë të sigurimit, nën këto rrethana, paditësja duke vepruar në bazë të nenit 18 paragrafi 1 i Ligji Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, ku parashihet se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”* ka kryer shpërblimin e dëmit tek i dëmtuari. Meqenëse paditësja i ka përmbushur obligimet ligjore në lidhje me kompensimin e dëmit, në bazë të nenit 18 par. 4 i Ligji Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, ku parashihet se: *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*, lidhur me nenin 136 paragrafi 1 i LMD-së, gjykata vlerëson se mjaftueshëm është vërtetuar se i padituri me veprimet e drejtpërdrejta të tij i ka shkaktuar dëm material paditëses dhe se ka detyrim ligjor që paditëses ti rimburojë dëmin material në shumën prej 528.00 euro, shumë kjo të cilën paditësja e ka paguar tek pala B.G.

Në momentin e vendosjes, gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të autorizuarit të të paditurit lidhur me atë se automjeti me të cilin është shkaktuar dëmi në momentin e aksidentit nuk ka qenë pronë e të paditurit, por ka qenë pronë e ndërmarrjes Thëngjilli sh.a në Obiliq dhe se ky ka qenë vetëm punëtor dhe se ky lloj automjeti nuk i nënshtrohet regjistrimit e as sigurimit të detyrueshëm dhe se dëmin eventual që ka pësuar i dëmtuari ka mundur të realizoj drejtpërsëdrejti prej pronarit të automjetit – ngarkuesit. Pretendimet e tilla Gjykata i vlerësoj si të pa bazuara, për arsye se me nenin 152 paragrafi par. 1 i LMD-së, parashihet se: *“Personi juridik ose fizik me të cilin punonjësi ka punuar në kohën e shkakimit të dëmit është përgjegjës për dëmin e shkaktuar ndaj personit të tretë nga punonjësi gjatë punës apo në lidhje me punën, përveç nëse provohet se punonjësi ka vepruar ashtu siç ka qenë e nevojshme në rrethanat konkrete.* Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni parashihet se : *“Pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit drejtpërdrejt nga punonjësi në rast se dëmin e ka shkaktuar me dashje.”* Në rastin konkret, gjykata vlerëson se është drejtë e paditëses BKS si palë e dëmtuar, që drejtpërdrejt të kërkojë shpërblimin e dëmit nga i padituri për faktin se nga ekspertiza e komunikacionit mjaftueshëm është vërtetuar se deri tek shkaktimi i dëmit ka ardhur si rezultat i neglizhencës dhe moskujdesit të drejtpërdrejtë të të paditurit dhe se i padituri është përgjegjës i vetëm në shkaktimin e këtij aksidenti.

Lidhur me kamatën ligjore prej 8% në vit, Gjykata ka vendosur konform nenit 382 par.1 lidhur me par.2 të LMD-së, duke e obliguar të paditurin që shumën e gjykuar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguajë së bashku me kamatën ligjore prej 8% e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë, gjegjësisht datë 26.10.2017, e deri në pagesën definitive.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 452 par.1 të LPK-së, duke e obliguar të paditurin që paditëses, t’ia kompensojë shumën e tërësishme të shpenzimeve deri në këtë fazë të procedurës në vlerë të përgjithshme prej 170.00 Euro dhe atë: 150.00 Euro në emër të përpilimit të ekspertizës së komunikacionit dhe 20.00 Euro në emër ta taksës gjyqësore për padi.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -  
C.nr. 2880/2022, date 01.02.2024

Gjyqtari,  
Ibrahim Maloku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.